

Pasqyrat Financiare

NOA Energy Trade sh.p.k

Më dhe për periudhen 31 Dhjetor 2020

Përmbajtja

Raporti i Audituesit të Pavarur	Faqe
Pasqyra e Pozicionit Financiar	i-iii
Pasqyra e Performancës Financiare	1
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	2
Pasqyra e Flukseve të Parasë	3
Shënimet për Pasqyrat Financiare	4
	5-19

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionerët e NOA Energy Trade sh.p.k

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të 'NOA Energy Trade sh.p.k' ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2020, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë entitetin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të entitetit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
28 korrik 2021

Kledion Halimi, SCF





Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Aktivët			
Aktivët afatshkurtra			
Mjete monetare	6	5,967,152	14,503,794
Të drejta të arkëtueshme	7	561,713,198	550,110,195
Aktive të tjera	8	250,672,864	300,353,211
Totali i aktive afatshkurtra		818,353,214	864,967,200
Aktivët afatgjata			
Investime në Filiale	9	100,000	-
Investime financiare	10	56,827,614	56,827,614
Aktive afatgjata materiale	11	90,507,284	94,726,058
Aktive afatgjata jo materiale	12	22,401,268	26,558,720
Totali i aktiveve afatgjata		169,836,166	178,112,392
Aktivët totale		988,189,380	1,043,079,592
Detyrimet			
Detyrimet Afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	13	147,236,579	43,908,769
Hua afatshkurtra	14	439,704,707	683,988,054
Detyrime të tjera	15	52,549,631	23,889,747
Totali i detyrimeve afatshkurtra		639,490,917	751,786,570
Kapitali			
Kapitali i paguar	16	291,293,021	100,000
Fitim i pashpemdare		-	130,757,377
Fitim i periudhës		57,405,442	160,435,645
Totali i Kapitalit		348,698,463	291,293,022
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		988,189,380	1,043,079,592

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Drejtimi i NOA Energy Trade sh.p.k më 31.03.2021 dhe firmosur për llogari të tyre nga:


Netiona Koprendka
Administrator


Lindita Metalla
Ekonomiste

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-19 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës Financiare

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të ardhurat operative			
Të ardhura nga shërbimet	17	1,009,351,211	2,487,825,354
Shpenzimet operative			
Shpenzime administrative	18	(904,885,288)	(2,238,160,749)
Shpenzime personeli	19	(4,307,623)	(8,510,068)
Zhvierësimi dhe amortizimi		(8,475,486)	(6,483,409)
Totali i shpenzimeve operative		(917,668,397)	(2,253,154,226)
Fitimi operativ		91,682,814	234,671,128
Të ardhura/shpenzime nga interesi		(21,600,121)	(47,609,407)
Fitimi/(humbja) nga kursi i këmbimit, neto		(327,236)	2,160,463
Fitimi para tatimit		69,755,457	189,222,184
Shpenzim tatim fitimi	20	(12,350,015)	(28,786,539)
Fitimi neto për vltin		57,405,442	160,435,645
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të tjera gjithëpërfshirëse		57,405,442	160,435,645

Pasqyra e performancës financiare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 - 19 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali i paguar	Fitime të mbartura	Totali
Gjendja më 1 janar 2019	100,000	130,757,377	130,857,377
Fitimi për vitin	-	160,435,645	160,435,645
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2019	100,000	291,193,022	291,293,022
Gjendja më 1 janar 2020	100,000	291,193,022	291,293,022
Fitime të mbartura	291,193,022	(291,193,022)	-
Fitimi për vitin	-	57,405,442	57,405,442
Gjendja me 31 Dhjetor 2020	291,293,022	57,405,442	348,698,464

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 -19 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e Flukseve të Parasë

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Flukset monetare nga aktiviteti operativ			
Fitimi para tatimit		69,755,457	189,222,184
Rregullime për:			
Zhvierësime dhe amortizime	11/12	8,475,486	6,483,409
<i>Ndryshime në aktive dhe detyrime operative:</i>			
Të drejta të arkëtueshme		38,077,344	(343,480,991)
Llogari të pagueshme		131,987,694	(36,823,079)
Interes i paguar		(21,600,122)	(47,609,407)
Mjetet monetare të përdorura nga aktivitetet operative		226,695,859	(232,207,884)
Tatimi fitimi i paguar		(12,350,015)	(4,730,970)
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative		214,345,844	(236,938,854)
Flukset monetare nga aktiviteti investues			
Investime ne filiale		(100,000)	
Blerje e aktiveve afatgjata materiale		(99,260)	(20,798,355)
Blerje aktive afatgjata jo materiale			(27,716,350)
Flukset monetare neto nga aktivitetet investuese		(199,260)	(48,514,705)
Flukset monetare nga aktiviteti financues			
Overdraft		(222,683,226)	299,929,818
Flukset monetare nga aktiviteti financues		(222,683,226)	299,929,818
Rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre		(8,536,642)	14,476,259
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit		14,503,794	27,535
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit		5,967,152	14,503,794

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5- 19 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Shënimet për Pasqyrat Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria 'NOA Energy Trade' Shpk u themelua në 2 shtator 2014 si Person Juridik me NIPT L42203031A.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 'Për Shoqëritë Tregtare, dhe nga statuti i saj.

Veprimtaria kryesore e Shoqërisë është kryerja e aktivitetit të furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike duke shfrytëzuar burimet e energjisë, të cilat gjenden në natyrë dhe janë të rinovueshme. Gjatë vitit 2018. Shoqëria ka përfshirë në objektin e veprimtarisë në statutin e saj tregëtimin e certifikatave të gjelbra dhe të gazit.

Shoqëria ka të punësuar 3 punonjes.

Administratorët e Shoqërisë janë znj. Netiona Koprencka dhe znj. Besiana Antoni.

Adresa e Shoqërisë është Njësia bashkiake nr 5, rruga "Nikolla Tupe", Tiranë, Republika e Shqipërisë.

2. Bazat e përgatitjes dhe deklarata e përputhshmërisë

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit Pasqyrat Financiare në përputhje me legjislacionin Kontabël në Shqipëri. Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

2.2 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike. Bazat e matjes për çdo aktiv, detyrim, të ardhur apo shpenzim shpjegohen me detaje në vazhdim të këtij shënimi shpjegues.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të kërkon të përdoren vlerësime të rëndësishme kontabël. Gjithashtu është e nevojshme që drejtimi të përdorë gjykimin e tij në zbatimin e politikave kontabël të shoqërisë. Fushat në të cilat kanë një shkallë të lartë gjykimi dhe kompleksiteti, ose ku supozimet dhe vlerësimet kanë ndikim domethënës në pasqyrat financiare janë të paraqitura në shënimin 4 "Gjykime dhe çmuarje të rëndësishme kontabël".

3. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kryesore kontabël të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare janë të prezantuara më poshtë. Këto politika janë përdorur në mënyrë konsistente në të gjitha vitet e prezantuara, përveçse kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet në valutë të huaj

(a) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë. Monedha funksionale e Shoqërisë është Lekë. Përveçse në rastet kur shprehet ndryshe, informacioni financiar është i paraqitur në Lekë.

(b) Transaksionet dhe tepricat në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë përkthyer në Lekë duke përdorur kursin e ditës në datën e transaksionit. Të gjitha humbjet dhe fitimet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e këtyre transaksioneve dhe nga rivlerësimi i zërave monetare në monedhë të huaj me kursin e këmbimit të fundit të vitit njihen në fitim ose humbje.

Zërat jo-monetare nuk përkthehen në fund të periudhës por maten me kosto historike (këmbehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është kryer transaksioni), përveç rasteve kur zërat jo-monetare maten me vlerë të drejtë të cilat këmbehen duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të këmbimit të përdorura për të përkthyer zërat në Pasqyrën e pozicionit financiar të shprehura në monedhë të huaj, janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Euro	123.70	121.77
Dollar Amerikan	100.84	108.64

3.2 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset hyrëse bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat vijnë si rezultat i aktivitetit të zakonshëm të shoqërisë. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë e të arkëtueshmeve ose të hyrave nga shitja e të mirave dhe shërbimeve që vijnë nga aktiviteti i zakonshëm i shoqërisë. E ardhura paraqitet neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar ("TVSH"), kthimet, uljet tregtare.

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse. Të ardhurat njihen nëse ka mundësi që të realizohen flukse të ardhshme hyrëse dhe këto flukse mund të maten në mënyrë të besueshme.

3.3 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në fitim ose humbje gjatë përdorimit të shërbimit ose në datën në të cilën ato kanë ndodhur. Shpenzimet për garancitë njihen dhe ngarkohen kundrejt provizionit përkatës në momentin që njihet e ardhura e lidhur me to.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.4 Qiraja

Shpenzimet e qirave, në të cilat një pjesë e madhe e riskut dhe përfitimeve të pronësisë mbarten nga qiramarrësi, klasifikohen si qira financiare. Pagesat e kryera për qiranë financiare (neto nga ndonjë përfitim të marrë nga qiradhënësi) ngarkohen në fitim ose humbje me metodë lineare përgjatë periudhës së qirasë. Faktorët të cilat konsiderohen përfshijnë gjatësinë e afatit të qirasë në lidhje me jetën ekonomike të aktivit, vlerën aktuale e pagesave minimale të qirasë në lidhje me vlerën e drejtë të aktivit, dhe nëse Shoqëria merr pronësinë e aktivit në fund të afatit të qirasë

Të gjitha qiratë e tjera janë trajtuar si qira operative. Kur Shoqëria është një qiramarrësi, pagesat për marrëveshjet e qirasë operative njihen si shpenzim në bazë lineare përgjatë afatit të qirasë.

3.5 Përfitimet e punonjësve

Shoqëria është e detyruar nga legjislacioni Shqiptar në fuqi të depozitojë kontributet fikse për llogari të punonjësve në një fond social që manaxhohet nga Qeveria. Të gjithë pagesat dhe detyrimet njihen si shpenzim në periudhën në të cilën i takojnë.

3.6 Aktivet afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale mbahen me kosto historike minus amortizimin e akumuluar. Kosto historike përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit.

Kostot e mëpasshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivit vetëm kur është e mundshme që në të ardhmen ato të sjellin përfitime ekonomike për shoqërinë, dhe kur kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar çregjistrohet. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet njihen në fitim ose humbje në periudhën financiare në të cilën ato ndodhin. Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur. Normat e përdorura të amortizimit janë si më poshtë:

Aktive të qëndrueshme	%
Ndertesa	5
Pajisje Elektronike	25
Të tjera	20

Vlera e mbetur dhe jetëgjatësia e aktiveve afatgjata materiale rishikohet, dhe rregullohet nëse është e përshtatshme, në çdo datë të Pasqyrës së pozicionit financiar. Vlera kontabël e një aktivit shpenzohet menjëherë deri në shumën e rikuperueshme, nëse vlera kontabël e aktivit është më e madhe se shumën e vlerësuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet që vijnë nga zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale përcaktohen si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël të aktivit dhe njihet në fitim ose humbje të periudhës financiare.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.7 Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale përfshijnë koston e licencave për programe kompjuterike të cilat kapitalizohen nëse janë kryer për të blerë dhe instaluar programin kompjuterik. Këto kosto amortizohen mbi jetën e tyre të dobishme. Amortizimi ngarkohet në masën 15% me metodën e vlerës së mbetur.

3.8 Instrumentet financiare

Aktivitet dhe detyrimet financiare njihen kur shoqëria bëhet palë kontraktuale e instrumentit financiar dhe maten fillimisht me vlerën e drejtë të rregulluar me koston e transaksionit, përveç atyre të mbajtura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes të cilat njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe koston e transaksionit shpenzohen në fitim ose humbje.

3.8.1 Aktivet financiare

Shoqëria klasifikon aktivitet e saj financiare në këto kategori: aktive financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, huatë dhe të arkëtueshmet, aktive financiare të mbajtura deri në maturim dhe aktive financiare të vlefshme për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin janë blerë aktivitet. Drejtimi vendos klasifikimin e aktiveve financiare që në momentin e njohjes fillestare dhe e rivlerëson atë në çdo datë raportuese.

a) Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Kjo kategori ka dy nën-kategori: aktivitet financiare të mbajtura për tregtim dhe ato të klasifikuara me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes që në fillim. Një aktiv financiar është i klasifikuar në këtë kategori nëse është blerë me qëllim për t'u shitur në një periudhë afatshkurtër, nëse ai përbën një pjesë të portofolit të aktiveve financiare për të cilat ka evidencë për realizimin e fitimeve afatshkurtra. Aktivitet në këtë kategori janë klasifikuar si aktive afatshkurtra, shoqëria nuk ka asnjë aktiv të klasifikuar në këtë kategori.

b) Huatë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshmet janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv letrash me vlerë, përveç atyre që shoqëria kërkon t'i shesë në periudhë afatshkurtër ose janë përcaktuar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Huatë dhe të arkëtueshmet njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe pastaj maten me koston e amortizuar duke përdorur koston efektive të interesit, duke zbritur provizionin për zhvlerësim. Një provizion për zhvlerësim për huatë dhe llogaritë e arkëtueshme krijohet kur ka evidencë objektive që shoqëria nuk do jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë shumat në përputhje me kushtet e tyre në momentin fillestar.

c) Aktive financiare të mbajtura deri në maturim

Aktivitet financiare të mbajtura deri në maturim janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe me afat maturimi fiks, përveç atyre që plotësojnë kushtet e përkufizimit të huave dhe të arkëtueshmeve, që manaxhimi i kompanisë ka qëllimin dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim. Këto aktive njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me vlerën e amortizuar duke përdorur koston efektive të interesit, duke zbritur provizionin për zhvlerësim nëse ka. Një provizion për zhvlerësim për aktive financiare të mbajtura deri në maturim krijohet kur ka evidencë objektive që shoqëria nuk do jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë shumat në përputhje me kushtet e tyre origjinale. Shoqëria nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori në datën e raportimit.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.8 Instrumentet financiare (vazhdim)

3.8.1 Aktivet financiare (vazhdim)

d) Aktive financiare të disponueshme për shitje

Aktivitetet financiare të disponueshme për shitje janë aktive financiare jo derivative të klasifikuara në këtë kategori ose që nuk janë të klasifikuara në ndonjë kategori tjetër. Shoqëria nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori në datën e raportimit.

e) Njohja fillestare dhe çregjistrimi

Blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare njihen në ditën e tregtimit, dita në të cilën shoqëria kryen blerjen apo shitjen e aktivitetit. Aktivitetet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, në rast se aktivi nuk është mbajtur me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes, kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Aktivitetet financiare të mbajtura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe kostot e transaksionit njihen në fitim ose humbje.

Aktivitetet financiare çregjistrohen, kur të drejtat për të përfituar flukse të mjeteve monetare prej tyre kanë skaduar ose kur ata janë transferuar dhe shoqëria ka transferuar në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin.

f) Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

Aktivitetet financiare të disponueshme për shitje dhe aktivitetet financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes maten edhe më pas me vlerën e drejtë. Huatë dhe të arkëtueshmet maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes janë të përfshira në fitim ose humbje në zërin (humbje)/fitime të tjera në periudhën në të cilën ato ndodhin. Fitimet dhe humbjet e përcaktuara që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve jomonetare të klasifikuara si të disponueshme për shitje njihen në kapital. Kur letrat me vlerë të klasifikuara si aktive financiare të disponueshme për shitje janë shitur ose zhvlerësuar, rregullimet e akumuluar të vlerës së drejtë të njohura në kapital përfshihen në fitim ose humbje si "fitim ose humbje nga aktivitetet financiare"

Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes janë të përfshira neto në fitim ose humbje në zërin (humbje)/fitime të tjera në periudhën në të cilën ato ndodhin. Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumentave financiarë monetare dhe jo-monetare në kategorinë 'të disponueshme për shitje' njihen në kapital.

Interesi nga aktivitetet financiare të disponueshme për shitje i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv është njohur në Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse si pjesë e të ardhurave të tjera. Dividendët nga aktivitetet financiare të disponueshme për shitje janë njohur në fitim ose humbje si pjesë e të ardhurave të tjera në momentin kur është fituar e drejta e kompanisë për të marrë pagesat në lidhje me to.

Vlera e drejtë e aktiveve të kuotuar është bazuar në çmimet e ofertës aktuale. Në qoftë se tregu për një aktiv financiar nuk është aktiv (dhe për letrat me vlerë të pa listuara), shoqëria e përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi. Këto teknika përfshijnë marrjen në konsideratë të transaksioneve më të fundit, referencë me instrumenta financiare të tjerë në substancë të ngjashëm, analizën e skontimit të flukseve monetare etj.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.8 Instrumentet financiare (vazhdim)

3.8.2 Detyrimet financiare

Detyrimet financiare të shoqërisë përfshijnë llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme ndaj aksionarëve. Detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë të përshtatura me kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e tyre. Detyrimet financiare më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.8.3 Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shumat e tyre neto raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë ligjore e zbatueshme për të kompensuar shumat e njohura dhe ka qëllim për t'i vendosur mbi bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyeje detyrimin njëkohësisht.

3.9 Zhvlerëslmi

3.9.1 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyre individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyre të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.9.2 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.10 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe paraqet shumën e tatimeve të pagueshme dhe të shtyra. Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, i cili llogaritet duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e bilancit dhe ndonjë rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Fitimi fiskal ndryshon nga fitimi neto i raportuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sepse përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshëm në vitet e tjera dhe gjithashtu përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që nuk janë asnjëherë të tatueshme ose të zbritshëm.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.11 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në arke, depozita afatshkurtra në bankë dhe investime të tjera afatshkurtra likuide me maturitet më pak se 3 muaj.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet kur shoqëria ka një detyrim aktual si rezultat i një ngjarje të shkuar dhe është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për vlerën e detyrimit. Provizionet nuk njihen për humbje të ardhshme operative. Provizionet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që do të duhen për të shlyer detyrimin, duke përdorur një normë skontimi e cila përfaqëson vlerësimin aktual të vlerës në kohë të parase dhe rreziqet specifike të detyrimit. Rritja e provizionit me kalimin e kohës njihet si shpenzim interesi.

3.13 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet shpjeguese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme. Shuma e një humbje të kushtëzuar njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provizionin, një detyrim njihet në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

3.14 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe manaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme, vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

3.15 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

3.16 Parimi i vijlmesisë

Gjatë fillimit të vitit 2020, në nivel global u përhap pandemia e COVID-19. Në mars të vitit 2020, qeveria e Shqipërisë mori masa drastike duke pezulluar të gjitha aktivitetet që nuk ishin jetësore. Pandemia Covid-19 nuk ka patur ndikim të konsiderueshëm duke marrë në konsideratë llojin e shërbimit të ofruar.

Aktiviteti i Shoqërisë ka vazhduar pa ndërprerje gjatë 2020, dhe ka patur një performancë relativisht të qëndrueshme.

Drejtimi nuk është në dijeni për ndonjë pasiguri materiale që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi.

4. Manaxhimi i rrezikut financiar

4.1 Faktorët e rrezikut financiar

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare që përfshijnë rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit. Manaxhimi i rrezikut të shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të shoqërisë.

a) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si pasojë e ndryshimit të çmimeve, kursit të këmbimit dhe normës së interesit në treg. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit shoqëria është e ekspozuar në një moment të caktuar varet nga kushtet në të cilat ndodhet tregu, pritshmëritë për çmimet në të ardhmen ose lëvizjet në normat e interesit të tregut, përbërja e aktiveve materiale të shoqërisë dhe kontratat në të cilat shoqëria është përfshirë.

i) Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria operon dhe është e ekspozuar ndaj kursit të këmbimit me valutat e huaja, veçanërisht me monedhat Euro dhe dollar amerikan. Rreziku i kursit të këmbimit vjen kur ka njohje të transaksioneve tregtare si aktive ose detyrime në një monedhë e cila është e ndryshme nga monedha funksionale e shoqërisë.

Shoqëria nuk e diversifikon ekspozimin ndaj këtij lloji rreziku sepse nuk pret humbje të konsiderueshme si pasojë e luhatjeve të kursit të këmbimit me monedhat e huaja krahasuar me kursin në datën e raportimit.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 ka qenë si më poshtë:

31 dhjetor 2020	EUR	LEK	USD	Totali
Aktivt financiare				
Mjete monetare	5,854,376	105,894	6,882	5,967,152
Të drejta të arkëtueshme	558,839,353	2,873,845	-	561,713,198
Totali	564,693,729	2,979,739	6,882	567,680,350
Detyrime financiare				
Llogari të pagueshme	147,123,980	112,599	-	147,236,579
Overdraft	439,704,707	-	-	439,704,707
Totali	586,828,687	112,599	-	586,941,286
Rreziku nga kursi i këmbimit 31 dhjetor 2020	(22,134,958)	2,867,140	6,882	(19,260,936)

31 dhjetor 2019	EUR	LEK	USD	Totali
Aktivt financiare				
Mjete monetare	14,365,424	138,006	364	14,503,794
Të drejta të arkëtueshme	547,347,795	2,762,400	-	550,110,195
Totali	561,713,219	2,900,406	364	564,613,989
Detyrime financiare				
Llogari të pagueshme	43,473,009	435,760	-	43,908,769
Overdraft	683,988,054	-	-	683,988,054
Totali	727,461,063	435,760	-	727,896,823
Rreziku nga kursi i këmbimit 31 dhjetor 2019	(165,747,844)	2,464,646	364	(163,282,834)

4. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.1 Faktorët e rrezikut financiar (vazhdim)

Analiza e ndjeshmërisë ndaj monedhave të huaja

2020	Shuma neto	10%	-10%
EUR	(22,134,958)	(2,213,496)	2,213,496
USD	6,882	688	(688)
2019	Shuma neto	10%	-10%
EUR	(165,747,844)	(16,574,784)	16,574,784
USD	364	36	(36)

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zërat monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të vitit, dhe një korigjim i vlerave të tyre është bërë për 10% ndryshim në kurset e këmbimit. Vlerat pozitive/negative tregojnë një rritje/ulje të fitimit ose kapitalit, e cila ndodh kur Leku forcohet/dobësohet ndaj një monedhe të huaj me +/- 10%.

ii) Rreziku i normës së interesit

Të gjithë aktivet e shoqërisë të cilat mbartin interesa lidhen me llogaritë në banka. Të ardhurat e shoqërisë dhe flukset e parave nga aktiviteti operacional nuk janë të ekspozuar në masë të konsiderueshme ndaj ndryshimeve në normat e interesit të tregut.

b) Rreziku i kreditit

Shoqëria ekspozohet ndaj rrezikut të kreditit, i cili ka të bëjë me rrezikun që njëra palë e një instrumenti financiar të shkaktojë një humbje financiare për palën tjetër duke dështuar të shlyejë detyrimet. Rreziku i kreditit vjen nga paraja dhe ekuivalentët e saj, depozitat në banka dhe institucionet financiare si dhe ekspozimi nga kreditimi i klientëve, duke përfshirë llogaritë e arkëtueshme dhe transaksionet e kryera. Rreziku i kreditit që vjen nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj dhe depozitat bankare konsiderohet i papërfillshëm, sepse pala tjetër janë banka me reputacion dhe me cilësi të lartë sipas klasifikimeve nga agjencitë e huaja.

Rreziku maksimal i ekspozimit të shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit përfaqësohet nga vlera e mbetur e secilit aktiv të pasqyrës së pozicionit financiar të paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Mjete monetare	5,967,152	14,503,794
Të drejta të arkëtueshme	561,713,198	550,110,195
Total	567,680,350	564,613,989

c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që një njësi ekonomike do të përballë me vështirësi për të përmbushur detyrimet që lidhen me detyrimet financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj nevojave të përditshme për burime monetare, kryesisht për të shlyer detyrimet e krijuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj normal. Drejtimi monitoron çdo ditë, javë dhe muaj duke bërë parashikime për flukset e parave.

4. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.1 Faktorët e rrezikut financiar (vazhdim)

c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Tabela më poshtë analizon detyrimet financiare sipas maturimit duke u bazuar në periudhën e mbetur nga data e raportimit deri në datën e maturimit sipas kontratës. Shumat e paraqitura në tabelën më poshtë janë flukset e parave të pa skontuara sipas kontratës. Balancat deri në 12 muaj barazohen me vlerën e tyre kontabël sepse ndryshimi me vlerën e skontuar nuk është i konsiderueshëm.

31 dhjetor 2020	Më pak se 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Aktivët financiarë				
Mjete monetare	5,967,152	-	-	5,967,152
Të drejta të arkëtueshme	561,713,198	-	-	561,713,198
Totali	567,680,350	-	-	567,680,350
Detyrime financiare				
Llogari të pagueshme	147,236,579	-	-	147,236,579
Overdraft	-	439,704,707	-	439,704,707
Total	147,236,579	439,704,707	-	586,941,286
Rreziku i likuiditetit 31 dhjetor 2020	420,443,771	(439,704,707)	-	(19,260,936)

31 dhjetor 2019	Më pak se 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Aktivët financiarë				
Mjete monetare	14,503,794	-	-	14,503,794
Të drejta të arkëtueshme	550,110,195	-	-	550,110,195
Total	564,613,989	-	-	564,613,989
Detyrime financiare				
Llogari të pagueshme	43,908,769	-	-	43,908,769
Overdraft	-	683,988,054	-	683,988,054
Total	43,960,025	683,988,054	-	727,896,823
Rreziku i likuiditetit 31 dhjetor 2019	520,705,220	(683,988,054)	-	(163,282,834)

4.2 Manaxhimi i rrezikut të kapitalit

Objektivat e Shoqërisë në menaxhimin e kapitalit janë të ruajë aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar biznesin në vijimësi në mënyrë që të sigurojë përfitime për aksionaret dhe përfitime për palët e tjera të interesuara dhe të mbajë një strukturë optimale kapitali për të reduktuar koston e kapitalit.

Struktura e kapitalit të shoqërisë përbëhet nga kapitali i pronarit dhe humbjet e akumuluar. Drejtimi rishikon strukturën e kapitalit në terma vjetore.

4.3 Vlerësimi me vlerën e drejtë

Vlera e drejtë përfaqëson vlerën me të cilën një aktiv mund të zëvendësohet ose një detyrim të shlyhet në kushte të tregut. Vlera e drejtë është bazuar në supozimin e drejtimit në përputhje me profilin e aktivit dhe bazën e detyrimit.

(a) Aktivët financiarë të mbajtura me koston e amortizuar

Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera duhet të përafrohet me vlerën kontabël përderisa janë instrumente afatshkurtër.

(b) Detyrimet financiare të mbajtura me koston e amortizuar

Vlera kontabël e llogarive të pagueshme dhe të pagueshme të tjera duhet të përafrohet me vlerën e drejtë. Shoqëria nuk mban detyrime të tjera financiare.

5 Gjykime dhe çmuarje të rëndësishme kontabël

Në zbatimin e politikave kontabël të shoqërisë, të cilat përshkruhen në shënimin shpjegues 3, drejtimit i duhet të bëjë vlerësime, gjykime dhe supozime për vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve që nuk kanë një vlerësim të qartë nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to bazohen në eksperiencë të mëparshme dhe faktorë të tjerë që konsiderohen të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime dhe supozime.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Vlerësimet kontabël rrallë do të rezultojnë të barabarta me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet, të cilat kanë rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar ndryshime materiale në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar shtjellohen më poshtë.

Paqartësia në gjykime

(a) Tatimi mbi të ardhurat

Shoqëria është subjekt i tatimit të fitimit në Shqipëri. Gjykimi i konsiderueshëm kërkohet për të përcaktuar vlerën e tatimit fitimit. Ka shumë transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi nga legjislacioni është i paqartë. Shoqëria njeh detyrimet për tatimin e parashikuar për çështje të auditimit bazuar në vlerësimet nëse do të ketë shtim në detyrimin tatimor. Kur detyrimi tatimor final për këto çështje është i ndryshëm nga vlera që ishte njohur fillimisht, diferenca ndikon tatimin aktual dhe atë të shtyrë për periudhën në të cilën janë bërë përcaktimet.

(b) Vlera e drejtë e aktiveve financiare

Vlera e drejtë e instrumentave financiare, të cilat nuk tregtohen në një treg aktiv (të gjitha aktivet e Shoqërisë) përcaktohet duke përdorur metoda vlerësimi. Shoqëria përdor gjykimin në zgjedhjen e metodave të ndryshme dhe bën supozimet që bazohen kryesisht në kushtet ekzistuese të tregut në çdo datë raportimi.

(c) Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi rishikon jetën e dobishme të aktiveve të amortizuara në çdo datë të raportimit financiar. Drejtimi vlerëson se jeta e dobishme e përcaktuar e aktiveve përfaqëson përdorimin e pritshëm të aktivitetit. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të daljes jashtë përdorimit si pasojë e teknologjisë.

(d) Njohja e të ardhurave

Shoqëria përdor metodën e njohjes së të ardhurave sipas fazës së përfunduar të punimeve dhe çmimet fikse të përcaktuara në kontratë. Përdorimi i kësaj metode kërkon që shoqëria të vlerësojë shërbimin e kryer në një datë, në proporcion me shërbimin total të parashikuar. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga vlerësimet dhe parashikimet e bëra.

Shumat janë të shprehura në LEK nëse nuk shprehet ndryshe

6 Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj

Mjetet monetare analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Mjete monetare në arkë		
Në lekë		
Në Euro	-	66,550
	-	-
Mjete monetare në banka		66,550
Në lekë		
Në Valutë	105,894	71,456
	5,861,258	14,365,788
Total	5,967,152	14,437,244
	5,967,152	14,503,794

Mjetet monetare në banka janë të lira në llogari rrjedhëse.

7 Të drejta të arkëtueshme

Të drejta të arkëtueshme analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Klientë		
Total	561,713,198	550,110,195
	561,713,198	550,110,195

Shoqëria ka bërë vlerësimin e mbledhshmërisë së klientëve dhe nuk ka njohur ndonjë provizion gjatë vitit 2020 dhe 2019. Klienti kryesor i shoqërisë është Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE):

8 Aktive të tjera

Aktive të tjera analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Garanci bankare		
Parapagime ndaj ortakut	6,685,000	10,241,600
Parapagime ndaj palëve të treta	49,158,021	66,897,803
Parapagime për blerje toka	27,504,137	72,637,087
Noa Development	26,938,090	51,324,490
Noa Control	138,702,418	485,433
Noa Inspect	-	87,969,945
TVSH dhe taksa të kreditueshme	-	6,196,000
Parapagime për Miinvest	241,241	2,456,872
Paradhënie page	1,144,828	1,144,828
Të tjera	238,328	210,639
Total	60,801	788,514
	250,672,864	300,353,211

Parapagime ndaj Ortakut janë pa afat, në lek dhe nuk mbartin interes. Parapagime për blerje toka janë kryer në bazë të kontratave premtimi për shit-blerje toka të lidhura me palë të treta, për zgjerimin e aktivitetit të Shoqërisë në periudha të ardhshme. Garanci bankare janë garanci të dhëna për rritjen e kapacitetit të shoqërisë.

9 Investime në filiale

Investimi në filiale përfaqëson investimin në kompaninë ERA REAL ESTATE ALBANIA sh.p.k themeluar në janar 2020.

10 Investime financiare

Të drejta financiare në vlerën 56,827,614 lekë përfaqëson investim në aksione të mbajtura me kosto që Noa Energy Trade shpk zotëron në një kompani amerikane.

11 Aktivet afatgjata materiale

Kosto	Mjete Transporti	Pajisje Elektronike	Pajisje Zyrash dhe te tjera	Toka	Totali
Gjendja më 1 janar 2019	30,462,777	652,729	2,524,453	52,732,000	86,371,959
Shtesa		208,723		20,589,631	20,798,354
Gjendja më 31 dhjetor 2019	30,462,777	861,452	2,524,453	73,321,631	107,170,313
Gjendja më 1 janar 2020	30,462,777	861,452	2,524,453	73,321,631	107,170,313
Shtesa			99,260		99,260
Gjendja më 31 dhjetor 2020	30,462,777	861,452	2,623,713	73,321,631	107,269,573
Zhvierësim i akumuluar					
Gjendje më 1 janar 2019	(6,092,555)	(223,074)	(802,847)	-	(7,118,476)
Shtesa	(4,874,044)	(107,413)	(344,322)		(5,325,779)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	(10,966,599)	(330,487)	(1,147,169)	-	(12,444,255)
Gjendja më 1 janar 2020	(10,966,599)	(330,487)	(1,147,169)	-	(12,444,255)
Shtesa	(3,899,235)	(143,341)	(275,458)		(4,318,034)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	(14,865,834)	(473,828)	(1,422,627)	-	(16,762,289)
Vlera kontabël neto					
Më 31 dhjetor 2019	19,496,178	530,965	1,377,284	73,321,631	94,726,058
Më 31 dhjetor 2020	15,596,943	387,624	1,201,086	73,321,631	90,507,284

Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, Shoqëria nuk ka prona të vëna si garanci. Nuk ka detyrime kontraktuale për të blerë aktive afatgjata materiale si më 31 Dhjetor 2020.

12 Aktivet afatgjata jo materiale

Aktivët afatgjata jo materiale janë licensa të blera në lidhje me zgjerimin e aktivitetit të tregut të Energjisë

Kosto	Licensa
Gjendja më 1 janar 2019	-
Shtesa	
Gjendja më 31 dhjetor 2019	27,716,350
Gjendje më 1 janar 2020	27,716,350
Shtesa	
Pakësime	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	27,716,350
Zhvierësim i akumuluar	
Gjendje më 1 janar 2019	-
Shtesa	
Gjendja më 31 dhjetor 2019	(1,157,630)
Gjendje më 1 janar 2020	(1,157,630)
Shtesa	
Gjendja më 31 dhjetor 2020	(4,157,452)
	(5,315,082)
Vlera kontabël neto	
Më 31 dhjetor 2019	26,558,720
Më 31 dhjetor 2020	22,401,268

13 Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të pagueshme nga aktiviteti	147,236,579	43,908,769
Total	147,236,579	43,908,769

14 Hua afatshkurtra

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Overdrafte	439,704,707	683,988,054
Total	439,704,707	683,988,054

Gjatë vitit 2018, Shoqëria ka lidhur kontrata overdrafti përkatësisht me Bankën Credins Sh.a dhe overdraftet kanë si barra sigurorese kolaterale në pronësi të Ortakut të Shoqërisë.

15 Detyrime të tjera

Detyrime të tjera analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Te pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	138,406	105,031
Të pagueshme për detyrimet tatimore	12,026,299	23,784,716
Hua ndaj të tretëve	24,748,320	-
Noa Control	12,662,623	-
Era Albania	100,000	-
Detyrime të përlogaritura	2,873,983	-
Total	52,549,631	23,889,747

Hua ndaj të tretëve perfaqëson financimin e dhënë përmes overdraft-it në shumën 200,000 EUR pa interes dhe maturitet të përcaktuar, me qëllim zgjerimin e aktivitetit të Shoqërisë. Detyrime të përlogaritura lidhen me faturimin në janar 2021 të shpenzimeve që i përkasin muajit dhjetor 2020.

16 Kapitali i paguar

Kapitali i paguar më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 analizohet si më poshtë:

Ortakët	Pjesëmarrja %	31 dhjetor 2020 lekë	31 dhjetor 2019 lekë
Gentian Sula	100%	291,293,021	100,000
Total	100%	291,293,021	100,000

17 Të ardhura nga shërbimet

Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Shitje e energjisë elektrike e të tjera	1,009,351,211	2,487,825,354
Totali	1,009,351,211	2,487,825,354

18 Shpenzime administrative

Shpenzime administrative analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Blerje energjie	796,536,862	2,125,444,036
Shpenzime për qira	243,858	231,316
Blerje kapacitete	59,435,575	40,248,541
Shpenzime për autorizime e licenca	2,073,027	130,000
Transferime, udhëtim, dieta	4,377,138	11,879,740
Konsulenca, studime dhe kërkime	2,405,175	5,564,365
Shpenzime ligjore dhe noterizime	259,200	292,474
Kancelari e të ngjashme	68,352	2,203,094
Personel nga jashtë ndërmarrjes		480,000
Shërbime bankare	5,557,647	7,118,057
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	4,200,000	6,062,739
Shpenzime të tjera	28,823,409	35,372,293
Shpenzime postare e telekomunikacioni	48,898	182,865
Gjoha	-	11,276
Sigurime	177,859	220,092
Trajnime	-	564,537
Taksa dhe tarifa vendore dhe doganore	189,000	1,721,299
Transporte	-	39,800
Shërbime auditimi	489,288	394,225
Totali	904,885,288	2,238,160,749

19 Shpenzime personeli

Shpenzime personeli analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Paga	4,155,412	7,804,128
Kontribute shoqërore dhe shëndetsore	152,211	705,940
Totali	4,307,623	8,510,068

20 Tatim Fitimi

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Fitimi i vitit	69,755,457	189,222,184
Shpenzimet e pazbritshme	12,577,975	2,688,074
Baza e tatueshme	82,333,432	191,910,258
Tatim Fitimi 15%	(12,350,015)	(28,786,539)
Fitimi Neto	57,405,442	160,435,645

21 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Çështje ligjore

Gjatë aktivitetit të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në dëme dhe çështje ligjore. Në gjykimin e drejtimit, shoqëria nuk do të ketë ngjarje me peshë të konsiderueshme për të ndikuar në pozicionin financiar të saj ose për të ndryshuar vlerën neto të aktiveve, përveç atyre për të cilat është njohur një provizion në pasqyrat financiare.

Detyrime të kushtëzuara

Shoqëria nuk ka detyrime të kushtëzuara të rëndësishme të kontraktuara deri në datën e pasqyrës së pozicionit financiar të cilat nuk janë njohur në pasqyrat financiare.

22 Ngjarje pas datës së raportimit

Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje pas datës së aprovimit të pasqyrave financiare të cilat mund të kërkojnë korrektimin e pasqyrave financiare.